



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

**ZYRA E KRYETARIT**  
**KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, si dhe në zbatim të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.15 të Ligjit nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.08/L-184 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, Kryetari i Komunës së Gjiçanit merr këtë:

**V E N D I M**

për

**themelimin e komisionit për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë së II-të**

1. Me këtë vendim, themelohet komisioni për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë së II-të, për të gjitha ndërtimet pa leje që janë ndërtuar ose e kanë filluar të ndërtohen pa leje, deri në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje.
2. Komisioni si në pikën 1 të këtij vendimi ka këtë përbërje:
  - 2.1. Ridvan Aliu- kryesues
  - 2.2. Naser Sylejmani-anëtar
  - 2.3. Arbër Shabani-anëtar
  - 2.4. Bejtullah Krasniqi-anëtar
  - 2.5. Feriz Terstena-anëtar
  - 2.6. Ahmet Daku-anëtar
  - 2.7. Xhelal Rrustemi-anëtar
3. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi, është i obliguar që t'i shqyrtoj të gjitha kërkesat – lëndët e pranura nga Drejtoria për Urbanizim, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, për legalizim të ndërtimeve pa leje të kategorisë së II-të, në bazë të dispozitave të ligjit nr.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.08/L-184 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-024, për trajtimin e ndërtimeve pa leje si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.
4. Komisioni për punën e tij do t'i raportojë me shkrim Kryetarit të Komunës.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr.02/2016 dt.10.07.2024 dhe vendimi 02/10 dt.06.01.2025.
6. Ky vendim hynë në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohen:

- Anëtarët,
- DUPMM-së dhe
- Arkivi.

